

**VENDIM**  
**Nr.198, datë 24.3.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM  
TË KOMUNËS POSTRIBË TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Postribë të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrative, të komunës Postribë të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.304, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Postribë të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Postribë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Postribë

Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës                                                                                                 | Lloji i transferimit |
|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| 1-9                                              | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                                                                      | Në pronësi           |
| 10-17                                            | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.                                                          | Në pronësi           |
| 20-22                                            | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.                                                 | Në pronësi           |
| 23-33                                            | Varrezat publike                                                                                                             | Në pronësi           |
| 34-42                                            | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.                                              | Në pronësi           |
| 43-70                                            | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).                       | Në përdorim          |
| 71,77,81,85,89,93,96                             | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta). | Në pronësi           |
| 483-490                                          | Infrastrukturë (rrugë vendore).                                                                                              | Në pronësi           |
| 495-505                                          | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.                                           | Në pronësi           |